



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 1109 Prot.

Tiranë, më: 04.02-2020

Vendimi 05

REFUZIM DEKLARATE MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjëseve e të afateve për zhvillimin e proçedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe proçedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI :

Mos pajisjen me Deklaratë Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person juridik: "ALBADITA" sh.p.k.

Nr. NIPT-i: J86906401D

Adresa e selise: Dibër, Martanesh, Krastë, Pallati Nr.12, Shkalla 1, Apartamenti 6

Personi përgjegjës: Gafurr Plloci

Për të zhvilluar projektin "**Shfrytëzim i mineralit të kromit me galeri dhe karrierë**"

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Objekti "mbi galerinë Nr. 4", Krastë, Bulqizë

(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat)

Bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:

Drejtoritë teknike të ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon:

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, **në rast se** zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën

Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti, ndodhet jashtë zonës së mbrojtur dhe nuk prek asnjë Monument Natyre.

2. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:

- Raporti VNM-së, është hartuar si VNM Paraprake, nuk janë mbajtur parasysh të gjitha sugjerimet e bëra në fazën e njoftimit për çështjet që duhet të trajtonte në raportin e thelluar të VNM-së, për sa i takon menaxhimit të mbetjeve që do të gjenerohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.
- Duke patur parasysh që shfrytëzimi është sipërfaqësor dhe ka një ndikim shumë të madh në mjedis, nuk janë zgjeruar problematikat që duhen trajtuar në Raportin e Thelluar të VNM, duke iu përmbajtur strukturës së hartimit të këtij raporti.
- Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, nuk janë përshkruar masat konkrete përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

DREJTORI I PËRGGJITHSHËM I AKM


EDISON KONOMI

MINISTRI


BLENDI KLOSI

